



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:168719

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514681

**C.nr.2714/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Njomëza Berisha, me bashkëpunëtorin profesional J.N. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses D.B.O. nga Prizreni të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 464.36 euro, jashtë seance, me datë 27.03.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.B.O. nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore Shkurt - Dhjetor 2020, shumën prej 9.38 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 174.02 euro;
3. Për periudhën kohore Janar – 20 Qershor 2022, në shumën prej 280.11 euro;

- **Në shumën e përgjithshme prej 463.94 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (18.08.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. REFUZOHET e pa bazuar**, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtej shumës së gjykuar si nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumë prej 0.42 euro, në emër të pagesës mbi bazën e inflacionit.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

### **A r s y e t i m**

Paditësja D.B.O. nga Prizreni në këtë gjykatë me datë 18.08.2022, përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit.

Në padi ka theksuar se paditësja është punëtore e arsimit pranë të paditurës e sistemuar në vendin e punës si mësimdhënëse në SHML “Gjon Buzuku” Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 29.11.2023, e ka precizuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën Komuna e Prizreni-Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të inflacionit për periudhën 01.02.2020 deri me datë 20.06.2022 tia kompensoj paditëses shumën prej 464.36 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 228 Euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumës prej 104 Euro, në emër të taksës shumën prej 20 Euro, në emër të përpilimit të precizimit shumën prej 104 Euro

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 24.03.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre

dispozitive marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Po ashtu e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2019 dhe deri me datë 25.08.2022 është parashkruar, sepse sipas nenit 353 të LMD-së kjo e drejtë është parashkruar Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditëses e lëshuar nga Komuna e Prizreni – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Gjon Buzuku” në Prizren, si mësimdhënëse, nga data 01.02.2020, e vazhdon tutje. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin, 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “*Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve*” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Shkurt - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses (e kërkuar) në vitin 2020 ka qenë 426.54 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 9.38 euro ( $426.54 * 0.2\% = 0.85 * 11$  muaj = 9.38 euro)
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses (e kërkuar) në vitin 2020 ka qenë 426.54 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 174.0 euro ( $426.54 * 3.4\% = 14.50 * 12$  muaj = 174.02 euro).
- Për periudhën Janar 2022 - 20 Qershor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses (e kërkuar) në vitin 2022 ka qenë 426.54 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 280.11 ( $426.54 * 11.6\% = (49.47 * 5$  muaj)+ ( $49.47 \div 30$  ditë = 1.64 \* 20 ditë = 32.8 Euro) = 32.98 Euro + 247.39 Euro = 280.11).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstaton se me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 18.08.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi dhe kërkesëpadia e paditëses nuk është e parashkruar dhe pretendimi i të paditurës për parashkrimin e kërkesës nuk qëndron sepse kërkesa i referohet periudhës 01.02.2020 deri me datë 20.06.2022 dhe konform nenin 87 të Ligjit të Punës është brenda afatit prej 3 viteve dhe nuk është e parashkruar.

Gjykata vendosi si në dispozitiv bazuar në kërkesën e paditëses edhe pse bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses, është shuma prej 459 euro. Mirëpo duke marrë për bazë se gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së vendos brenda kërkesës së palëve ndërgjyqëse dhe se paditësja ka kërkuar që kompensimi në emër të inflacionit të realizohet në bazë të pagës 426.54 euro, mbi këtë bazë gjykata morri për bazë lartësinë e pagës prej 426.54 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata vërtetoi se paditëses për vitin 2020 i takon shuma prej 9.83 dhe jo sa është kërkuar në lartësi prej 10.23, ashtu që shumën 0.42 cent e refuzoi si të pabazuar.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (18.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Ndërsa gjykata e gjeti si të pa bazuar kërkesën prej 104 euro në emër të precizimit të padisë pasi që është obligim i palës paditëse që padia me rastin e paraqitjes të jetë në përputhje me nenin 253 të LPK-së pra kërkesa të jete e caktuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil**  
**C.nr.2714/2022, datë 27.03.2024**

**B. Profesional**  
**Jeton Nezaj**

**Gjyqtarja**  
**Njomëza Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.